



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 488/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Rafet Haxhaj kryesues, Vllastimir Dimic dhe Ferid Osmani, anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër votuesit Ali Jakupi, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 14.12.2010, mori këtë:

VENDIM

REFUZOHET e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV)

Arsyetim

Më 13 dhjetor 2010, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjektit politik LVV ne te cilen parashtrohet ankesë kundër votuesit Ali Jakupi, duke pretenduar se më datë 12.12.2010 në QV në fshatin Sopi- Suhareke ky votues ka votuar dy herë. Parashtruesi i ankesës ka shtuar se këtij votuesi iu është tërhequr vërejtja për të mos votuar dy herë por nuk ka qene e mundur të evitohet kjo parregullsi.

Ne mbështetje te pretendimeve, parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë prove, por thotë se dëshmitarë ne vendngjarje janë te gjithë pjesëtarët e stafit te komisionit zgjedhor Vrbeshtice.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) parashohin si vijon:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku*

mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi te gjitha shkresat e lendes gjeti se:

- ankesa është e pabazuar

Nga shkresat e lendes PZAP vlerëson se ankesa e LVV-së ka mungesë të provave për t'u bindur se ka pasur parregullsi gjatë votimit si dhe nuk është ofruar asnjë provë si dëshmi bindëse për parregullësin e pretenduar. Për këto arsye, dhe duke u bazuar ne dispozitat e lartpërmendura si dhe ne kuptimin e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë

A nr. 488/2010 më datën 14.12.2010.

Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj

